

VENDIM
Nr. 697, datë 26.11.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 711, DATË 20.11.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR MARRËDHËNIET E
AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË, NË KUADËR TË
OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË
GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, e 12, pikat 2 e 6, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin, që i bashkëlidhet vendimit nr. 711, datë 20.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””, pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Regjistri i çështjeve gjyqësore

1. Pranë Avokaturës së Shtetit krijohet “Regjistri i çështjeve gjyqësore” për çështjet, në të cilat personat juridikë ose Republika e Shqipërisë është palë.

2. Çdo person juridik, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet personit të kontaktit të caktuar sipas nenit 5, të kësaj rregulloreje, duhet t’i ofrojë asaj informacion për të gjitha çështjet gjyqësore, ku është palë, gjykatën kompetente, shkallën dhe fazën e gjykimit të secilës çështje, datën dhe orën e zhvillimit të seancës së radhës, personin përgjegjës të caktuar nga personi juridik për të ndjekur çështjen, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm nga Avokatura e Shtetit dhe që ka lidhje me çështjen.

3. Avokatura e Shtetit regjistron e përditëson informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, dhe informacionin për çështjet, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, në regjistrin e çështjeve gjyqësore.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit përcakton formatin e regjistrit të çështjeve gjyqësore, mënyrën e mbajtjes e të përditësimit të të dhënave të këtij regjistri, si dhe të dhënat që mund të bëhen publike.

5. Në çdo rast, kur përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik nuk merr pjesë në proceset gjyqësore, ku ky i fundit është palë, Avokatura e Shtetit njofton:

- a) titullarin e institucionit shtetëror;
- b) titullarin e entit publik;
- c) administratorin e shoqërisë.”

II. Personat juridikë dërgojnë pranë Avokaturës së Shtetit informacionin e parashikuar në nenin 5/1 të rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, bashkëlidhur vendimit nr. 711, datë 20.11.2024, të Këshillit të Ministrave, brenda

30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Avokatura e Shtetit krijon regjistrin e çështjeve gjyqësore brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

III. Ngarkohen Avokatura e Shtetit dhe personat juridikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama